

DITARI MUJOR

Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët

Gusht



01

PËRMBYLLJA E KAMPIT "RINIA NDRYSHON LIGJET": FUQIZIMI I ZËRIT TË RINISË NË VENDIMMARRJE

Në kuadër të përmbylljes së procesit të rishikimit të Ligjit "Për Rininë" dhe Ligjit "Për Vullnetarizmin" të parashikuara në Strategjinë Kombëtare të Rinisë 2022-2029 sipas kërkesave të të rinjve gjatë procesit të hartimit, Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët organizoi bootcamp-in "Rinia Ndryshon Ligjet" që mbledhi plot 110 të rinj nga Këshillat Vendorë Rinorë, grupet Impakt dhe të rinj të tjerë. Me mbështetjen e World Vision Albania, ky kamp ofroi një platformë për diskutime të detajuara mbi ligjet ekzistuese, ndërsa të rinjtë ndanë perspektiva të freskëta dhe sugjerime konstruktive. Bootcamp-i "Rinia Ndryshon Ligjet" u karakterizua nga një energji pozitive dhe nga angazhimi aktiv i të rinjve, të cilët arritën të krijojnë lidhje të reja dhe të ndërtojnë një rrjet mbështetës për të ardhmen. Në përfundim, sugjerimet e të rinjve u përmbledhën dhe do të merren në konsideratë për të reflektuar në draftin përfundimtar të ligjeve, duke garantuar që zëri i rinisë të jetë pjesë integrale e procesit vendimmarrës në Shqipëri.

Ky aktivitet solli diskutime të frytshme me përfaqësues të politikëbërjes vendore, si Erion Isai, Kryetar i Bashkisë Kolonjë, dhe Renis Xhemollari, Nënkryetar i Bashkisë Durrës, të cilët theksuan rëndësinë e përfshirjes aktive të rinisë në proceset vendimmarrëse lokale. Në vijim, Besfort Lamallari, Zv/Ministër i Brendshëm, dhe Tedi Dobi, Zv/Ministër i Drejtësisë, përqendruan bisedat në politikëbërjen qendrore, duke eksploruar rolin e politikave kombëtare në mbështetjen e iniciativave rinore. Kampi ishte një mundësi unike për të rinjtë që të kontribuojnë në formësimin e të ardhmes së komuniteteve të tyre dhe të krijojnë lidhje të reja, të cilat do të zgjasin gjatë.



02

CERTIFIKATA PËR TË RINJTË NË DIBËR: PËRGATITJA E BREZIT TË RI TË PROGRAMUESVE NË SHQIPËRI

Në Dibër, Ministri i Shtetit për të Rinjtë dhe Fëmijët, Znj. Muzhaqi dhe Zëvendëskryeministrja, Znj. Balluku, shpërndanë certifikatat për 16 të rinj që përfunduan me sukses kursin e programimit në gjuhën Java. Ky kurs, i ofruar falas si pjesë e programit të kodimit të qeverisë shqiptare, synon të pajisë të rinjtë me aftësi të kërkuara në industrinë e teknologjisë dhe të rrisë përfshirjen e tyre në tregun e punës. Të rinjtë që morën pjesë në këtë program përfituan aftësi të forta në programim, duke fituar vetëbesimin dhe njohuritë e nevojshme për të konkurruar në një treg gjithnjë e më global. Ministrja Muzhaqi theksoi rëndësinë e këtij programi si një hap drejt fuqizimit të të rinjve shqiptarë për sfidat e shekullit të 21-të, ndërsa Zëvendëskryeministrja Balluku vlerësoi përkushtimin e pjesëmarrësve dhe rolin e qeverisë shqiptare në nxitjen e inovacionit dhe zhvillimit teknologjik.

Me këto aftësi të reja, të rinjtë janë të përgatitur për të kontribuar në transformimin digjital të Shqipërisë dhe për të gjetur punësim në industrinë teknologjike, si brenda ashtu edhe jashtë vendit.



REPUBLIKA E SHQIPËRIE
KRYEMINISTRJA
MINISTRI I SHTETIT PËR RININË DHE FËMIJËT

DITARI MUJOR

Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët

Gusht

Estela Sulaj
Ministria e Turizmit dhe Mjedisit
PROGRAMI KOMBËTAR I PRAKTIKAVE TË PUNËS

SKB
2023

Rozalinda Tojalli
Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë
PROGRAMI KOMBËTAR I PRAKTIKAVE TË PUNËS

SKB
2023

03

MBYLLET THIRRJA E IX E PROGRAMIT KOMBËTAR TË PRAKTIKAVE TË PUNËS

Me përfundimin e afatit të aplikimeve më 15 gusht, Thirrja e IX e Programit Kombëtar të Praktikave të Punës ka tërhequr 1332 aplikime nga të rinj të moshës 21-26 vjeç, të cilët synojnë të fitojnë përvojë praktike në administratën publike. Ky program, i cili ofroi mbi 1200 pozicione të lira, është një mundësi e shkëlqyer për të rinjtë që të zhvillojnë aftësitë e tyre profesionale dhe praktike përmes një përvojë pune 3-mujore pranë institucioneve të administratës shtetërore.

Programi, aktiv prej 9 vitesh, u ofron praktikantëve një certifikatë të njohur si përvojë pune dhe mundësinë për të fituar një kontratë pune 1-vjeçare, bazuar në performancën e tyre dhe nevojat e institucioneve pritëse. Ministrja e Shtetit për të Rinjtë dhe Fëmijët njoftoi rreth procedurave të ardhshme të PKPP, ku aktualisht janë ngritur komisionet vlerësuese në institucionet pjesëmarrëse dhe vlerësimi i aplikantëve nga komisionet.



04

SERIA E INTERVISTAVE "INTERVISTË ME MINISTREN": ZËRI I RINISË SHQIPTARE

Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët realizoi një seri intervistash të veçanta me të rinj aktivë dhe të dalluar në fusha të ndryshme, duke sjellë në vëmendje historitë e tyre frymëzuese. Pa skript, pa filtra, dhe pa montazh, këto intervista pasqyruan çiltërsinë dhe pasionin që rinia shqiptare sjell në komunitetin e tyre.

Në këto intervista, gjatë muajit gusht, të rinjtë ndanë përvojat dhe vizionet e tyre për tema të ndryshme si balancimi i aktiviteteve verore me edukimin, kombinimi i studimeve me aktivizmin, përparimi në art dhe muzikë, ruajtja e traditave dhe inovacioni, si dhe përfshirja e rinisë në komunitet dhe vullnetarizëm.



REPUBLIKA E SHQIPTARË
KRIVEMINISTRIA
MINISTRI I SHQITIT PËR RININË DHE FËMIJËT

DITARI MUJOR

Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët

Gusht



05

RIN CAMP 2024: FUQIZIMI I TË RINJVE PËRMES DISKUTIMEVE DHE INOVACIONIT

Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët në vijim të traditës disa vjeçare organizoi takimin 3-ditor me të rinjtë nga e gjithë Shqipëria. Në bashkëpunim me Agjencinë Kombëtare të Rinisë, organizoi RIN CAMP 2024, i cili synoi të aktivizonte dhe mbështeste të rinjtë në angazhimin e tyre në sferën rinore, duke u fokusuar në ngritjen e kapaciteteve personale dhe profesionale. Kampi ofroi një mjedis të larmishëm për pjesëmarrësit që të zhvillonin aftësitë e tyre përmes një sërë aktivitetesh dhe diskutimesh në përputhje të plotë me Strategjinë Kombëtare të Rinisë 2022-2029.

Përgjatë katër ditëve të kampit, të rinjtë u bënë pjesë e paneleve informuese dhe trajtuan tematika të rëndësishme si inovacioni dhe tregu i punës, digjitalizimi në arsim, mundësitë dhe politikat rinore, aftësitë e buta, si dhe edukimi financiar dhe përgjegjshmëria. Këto tema u përzgjedhën jo vetëm në kuadër të strategjisë, por edhe si një pasqyrim i propozimeve dhe interesave të vetë të rinjve, të cilët, përmes aplikimit, kanë shprehur prioritetet dhe fushat ku ndiejnë nevojën për më shumë njohuri dhe aftësi.

Kryetarët e bashkive të Vlorës dhe Himarës, ndanë punët dhe angazhimet e tyre për të rinjtë, duke treguar përkushtimin e tyre për zhvillimin e komuniteteve lokale. Gjithashtu, të rinjtë u përfshinë në një bashkëbisedim të hapur me Ministren e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Znj. Denaj ku u diskutua rëndësia e zhvillimit të qëndrueshëm dhe përdorimi i teknologjisë në bujqësi.

RIN CAMP 2024 shërbeu si një platformë ku të rinjtë jo vetëm që ndanë përvojat dhe vizionet e tyre, por edhe patën mundësinë të lidhen me liderët lokalë dhe ekspertët e fushave të ndryshme, duke përgatitur terrenin për angazhimin e tyre të ardhshëm në komunitet dhe tregun e punës.



REPUBLIKA E SHQIPËRIE
KRUEMINISTRIA
MINISTRI I SHTETIT PËR RININË DHE FËMIJËT